



# Aplikoni për mbështetje nga RCF

## Fondi Rajonal i Sfidave

Fondi Rajonal i Sfidave (RCF) synon të lehtësojë gjetjen e punonjësve të aftë për bizneset në WB6.

Kjo mundësohet duke krijuar lidhjen e duhur mes kompanive që kanë nevojë për një fuqi të aftë punëtore dhe institucioneve të trajnimit profesional (VTI), të cilat përdorin një qasje unike të trajnimit profesional bashkëpunues. Kjo qasje është më e efektive se mënyra tradicionale e arsimit dhe trajnimit profesional (VET).

Me ndihmën e RCF-së, VTI-të bëhen partnerë të kompanive duke ofruar një trajnim profesional bashkëpunues, për tu mësuar nxënësve aftësitë e kërkuara. RCF do të financojë investimet në pajisje dhe infrastrukturën për të cilat VTI-të kanë nevojë, në mënyrë që nxënësit të përvetësojnë aftësitë e duhura. Kjo nismë do të mundësojë punonjës të aftë dhe të gatshëm për punë.

### Trajnimi Bashkëpunues

- ✓ Një qasje që kombinon mësimin nëpërmjet VTI-ve me trajnimin praktik në vendin e punës në kompaninë pjesëmarrëse..
- ✓ Të diplomuarit do jenë lehtësisht të punësueshëm pasi zotërojnë aftësitë për të cilat biznesi ka nevojë.
- ✓ Kompanitë pjesëmarrëse do kenë rritje të produktivitetit, si dhe konkurrueshmëri dhe inovacion të shtuar.

### Përfitimet që ofrohen nga RCF

- ✓ RCF ndihmon VTI-të për harmonizimin e programeve përkatëse me nevojat e kompanive dhe pajis shkollat me teknologjinë moderne që bizneset përdorin sot.
- ✓ RCF lehtëson partneritetin mes bizneseve dhe VTI-ve të duhura për të hartuar një program trajnimi që u përshtatet nevojave të tyre.

## Kush mund të aplikojë për mbështetje nga RCF

**Konsorciumet e VTI-ve dhe bizneseve** që kanë nevojë për fuqi të aftë punëtore janë të mirëpritur të aplikojnë. Një konsorcium duhet të përbëhet nga:

✓ Një institut i licencuar trajnimesh profesionale, publik ose privat, si shkollat apo qendrat e arsimit profesional në vendet e WB6, që dëshirojnë të angazhohen në aktivitete të tilla.

✓ Të paktën dy ndërmarrjeprivate partnere.

Grantet e RCF-së do t'i jepen **VTI-ve si partnerë kryesorë** të konsorciumit, i cili do të kryejë trajnimet profesionale bashkëpunuese.

## Projektet e mbështetura nga RCF

Projekte që fokusohen tek **krijimi ose përmirësimi i trajnimevetë tilla bashkëpunuese**. Konsorciumet mund të aplikojnë për fonde për blerjen e pajisjeve e makinerive, për investime në ndërtim dhe rinovim, për përmirësim të kurrikulës dhe materialeve të trajnimit apo për trajnimin e mësuesve ose vetë trajnuesve brenda kompanisë, duke synuar forcimin e aspekteve praktike të kurseve të trajnimit.

**Shuma e granteve do të variojë nga 150.000 në 600.000 Euro.**



### Si të aplikoni

Thirrjet për aplikime do të shpallen një ose dy here në vit. Palët e interesuara mund të dorëzojnë elektronikisht një Shprehje Interesi e cila do të vlerësohet nga komiteti përzgjedhës, i përbërë nga ekspertë ndërkombëtarë të arsimit dhe aftësimit profesional. Konsorciumet e përzgjedhura do të ftohen të dorëzojnë më pas propozimet e plota të projektit.

## Për më shumë

Vizitoni [www.rcf-wb6.org](http://www.rcf-wb6.org) për të zbuluar më shumë rreth thirrjeve të hapura, kriterëve kualifikuese, procesit të aplikimit dhe eventeve të planifikuara në të ardhmen.



Na ndiqni



## Partnerët e implementimit

